



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.199/2012

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesit: nga te cilin e perfaqeson av. sipas autorizimi, kunder te paditurve: nga tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqeson Perfaqesuesi i Perkoheshem av. sipas aktvendimit te kcsaj gjykate dhe te paditurit : nga te cilin e perfaqeson av. ne sipas autorizimit Baza e kontestit: Vertetim pronesie, vlera e lendes se kontestit; 1.250,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.27.04.2017 me dt. 20.06.2017 , jep kete;

AKTGJYKIM

APROVOHET kerkespadia e paditesit: nga kunder te paditurit t nga dhe VERTETOHET se paditesi, eshte pronar i palujtshmerise te pjeses se parc.kat. ne vendin e quajtur ,, Rr. ,, me kultur are e klasit te dyte me siperfaqe S = 611 m2 me masa dhe kufij qe jane shenuar ne skicen e terenit e evidentuar ne emer te 1/1 ZK


Detyrohet i padituri qe t'ia njoh kete te drejte paditesit dhe te njejtit ti lejoj qe paditesi kete te drejte ta regjistroj prane Drejtorise per Gjeodezi dhe Kataster ne ne afatin prej 15 ditesh nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Refuzohet kerkesepadia e paditesit per shkak te heqjes dore nga kerkesepadia ndaj te paditurit te dyte; nga cila ka te beje me vertetimin e pronesise per parc.kat. me siperfaqe prej S = 14 m2 , ne vendin e quajtur ,, Rr. ,, are e klases se dyte, ZK-

Detyrohet paditesi qe te paditurit tia kompenzoj shpenzimet e procedures kontestimore ne shume prej 405.00 Euro. ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Arsyetim

Paditesi ne padine e parashtruar si dhe ne seancat e mbajtura permes te autorizuarit te tij ka thksuar se : babai i paditesit tani i ndjen gjysh para me shume se 50 vite me kontraten mbi shitblerjen e palujtshmerise e cila eshte zhdukur gjate luftes nga i padituri i pare per shumen prej 10.000,00 Dinare te cilen e ka paguar ne teresi e ka blere palujtshmerine e cekur nen piken I te



dispozitivit te ketij aktgjykimi ne te cilen ka ndertuar shtepine dhe qe nga atehere e shfrytezon pa pengesa dhe ka hy ne posedim dhe pronesi.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor hoqi dore nga kerkesepadia sa i perket te paditurit te dyte

Ne fjalen perfundiimtare I autorizuari I paditesit I propozoi gjykates qe padine si dhe precizimin e kerkesepadise ta aprovoj si te bazuar .

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk I kerkoj.

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr. te dt.12.03.2015 , te paditurit te pare i caktoi perfaqesuesin e perkoheshem av. nga cili ne baze te ketij aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet konform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mugnese te perfaqesuesit te perkoheshem te te paditurit te pare, konform nenit 423.4 te LPK-es.

I autorizuari i te paditurit te dyte deklaroi : se duke marre parasysh se i autorizuari i paditesit terhoqi kerkesepadine ndaj te paditurit te dyte une kerkoj shpenzimet e procedures kotestimore ne shume prej 405,00 Euro, qe kane te bejne me tri perfaqesime ne shume prej 135,00 Euro.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme, veproi dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne baze te nenit 8. te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet te vendoset si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.


Gjykata ne procedure e provave lexoi: qertifikaten e pronesise te dt. 16.11.2016 ne emer te ekspertizen e ekspertit gjeodet i te dt. 16,11,2016, Procesverbalin mbi kqyrjen ne vend te dt. 104.11.2016, beri veshtrimin ne skicen e terenit te dt.15.11.2015 dhe kopjen e planit te dt. 16.11.2016 si dhe degjoi paditesin ne cilesi te pales dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga qertifikata e pronesise e sipercekur konstatohet se: parcelat katastrale tani lendore evidentohen ne emer te 1/1 ZK

Nga ekspertiza e ekspertit gjeodet te sipercekur konstatohet se : pas matjeve te kryera te pjeses kontestuese te palujtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese bie – gjegjesisht e perbene parcelat e cekura me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe skicen e terenit te cilat jane pjese perberese te kesaj ekspertize dhe te pershkruara si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi .

Nga skica e terenit dhe kopja e planit, shifet shtrirja dhe perkufizimi I palujtshmerise tani lendore.

Nga procesverbali mbi kqyrjen ne vend I kesaj gjykate I dt. 04.11.2016 konstatohet se: gjyqtari me vrojtim te drejteperdrejte konstaton se : ne palujtshmerine lendore eshte shtepia e vjeter perdhese e



banuar , nje shtepi e re dy kateshe (2 + 1) e pabanuar e ndertuar vetem me blloka , nje lokal(Ordinance Specialistike "Urologjia" dhe se lokali i te paditurit te dyte eshte i mbeshtetur per shtepine e paditesit.

Paditesi ne cilesi te palet deklaroi: sipas asaje qe i ka treguar babai i tij tani i ndjer , palujtshmerine tani lendore i njeiti e ka blere nga shitesi . nga fsh. e qe qinimi nuk i kujtohet nga se ka qene femije kur eshte bere shitblerja. Qe nga shitblerja e deri me tani , babai si dhe te gjithet anetaret e familjes e kemi shfrytezuar ketë palujtshmeri pa pengese . Tani ne kete vend jane te ndertuara objektet sikurse qe jane konstatuar me rastin e kqyrjes ne vend. Tani kete palujtshmeri e ka ne shfrytezim dhe posedim te lire vetem paditesi . I njeiti ka pese vllezer dhe nje moter mirepo askush prej tyre asnjehere nuk ka pas kurfar pretendimi ne kete palujtshmeri dhe vetem paditesi banon ne palujtshmerine tani lendore .

Ne nje gjendje te ketill faktike te cekur me larte. gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi: se palujtshmerin tani lendore i ati i paditesit tani i ndjere , e ka blere nga i padituri i pare qysh para 50 vitesh me qmim te shitblerjes prej 10.000,00 dinare ne baze te marrveshjes gojore te cilin qmim ne teresi bleresi iu ka paguar shitesit dhe qe nga momenti i shitblerjes i ati i paditesit se bashku me familjen e tij te ngusht si dhe paditesi e kane pasur ne disponim dhe shfrytezim te lire pa u penguar nga askush . Pas shitblerjes ne kete palujtshmeri jane ndertuar objektet e sipercekura te cilat i shfrytezon paditesi pa ndonje pengese nga askush.

Nga provat e cekura me larte gjykata konstatoi: se edhe pse kjo kontrat gojore mbi shitblerje eshte permushur 100% , kjo patundeshmieri juridikisht gjere me tani nuk eshte bartur ne emer te blersit..

Ne nje gjendje te ketille faktike te vertetuar me larte, gjykata kerkesepadin e paditesit e aprovoi ne teresi si te bazuar sin en piken I. te dispozitivit te aktgjykimit konform nenit 21 dhe 28 te LTHMPJ-es, Gaz.Zyrt RSFJ nr ne fuqi prej 1 Shtatorit 1980 (neni 90) deri me 20 Gusht 2009 (nenit 296-297 te Ligjit nr.03/L-54) mbi Pronesine dhe te drejtat e tjera sendore (Gaz.Zyrt. e Republikes se Kosoves nr.57/2009 ne Kosove ne fuqi nga 22 Marsi 1989 eshte Ligj I aplikueshem bazuar ne nenin 1.1 (b) te Rregullores se UNMIK-ut nr.1999/24.

Ne baze te nenit 21 te LMTHPJ-es, eshte percaktuar se : sipas ligjit pronesia fitohet nder te tjera edhe me mbajtje.

Ne baze te nenit 28.al.4. te te njejtig ligj, parashifet kalimi I kohes prej 20 vitesh per mbajtesin e ndershem. Ne baze te provave te cekur me larte e duke marre parasysh se kete palujtshmeri i ati i paditesit e ka blere qysh para 50 viteve e qe nga ky moment i ati i paditesit si dhe paditesi e ka ne shfrytezim te lir gjere me tani, gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronsise nga ana e paditesit dhe ate : ne menyre origjinere , me mbajtje duke filluar qysh para 50 viteve e gjere me tani , nga se i ati i paditesit si dhe paditesi kane qen mbajtes te ndershem te kesaj palujtshmerie tani lendore, nga se ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise edhe ne baze te mbajtjes : mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme dhe shfrytezimi I papengueshem I kesaj patundeshmerie.

Edhe ne baze te nenit 40 te Ligjit per pronsi dhe te drejtat tjera sendore (Ligji nr.03/L-154) eshte percaktuar se: personi I cili me mirebesim e ka 20 vjet ne posedim te panderprere nje palujtshmeri ose nje pjese te saj e fiton pronsin me te.

Sa i perket pikes II. te dispozitivit te aktgjykimit, gjykata vendosi konform nenit 149.1 dhe 2 te LPK-es.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore bazohet ne dispoziten e nenit 465.1 dhe 453.2 te LPK-se , duke i njohur te paditurit te dyte shpenzimet per perfaqesim ne tri seance nga i autorizuari i tij, shumen prej nga 135,00 Euro , konform nenit 7 te T.A.

Nga si tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij akgykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË
C.nr.199/2012 me dt.20.06.2017



KESHILLE JURDIKE : Kunder ketij akgykimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e pranimit , Gjykates se Apelit te Kosoves, e permese kesaj gjykate.

Handwritten notes:
- e-ep
- shp. 13
- Exp. me dt
20.06.17
S. Hoti

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA

VENDIM I ESHTË I PLOTËFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOBËNDE
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
MITROVICË / MITROVICA

Me
Data:

21.07.2017